

**Kërkuese (e dëmtuar akuzuese):** Xhoana Nano, e bija e Virgilit, e datëlindjes 25/05/1973, banuese në Tiranë, rruga "Reshit Collaku", Nr.2, perfaqësuar me prokurë nga Av. Evelina Qirjako.

**Objekti:** Kërkohet procedimi ndaj z. Nikolle Lesi, i biri i Palit, i datëlindjes 06/08/1963, lindur në Lezhë e banues në Tiranë, rruga "Sami Frashëri", deputet, për veprat penale të shpifjes e fyerjes dhe shpërbllimi i dëmit.

**Baza ligjore:** Nenet 119/2, 120/2 të Kodit Penal, nen 59 e 78/b i Kodit të Procedurës Penale, shtuar me Ligjin Nr.8813, datë 13.06.2002.

### **Përpara Gjykatës së Lartë**

**Tiranë**

z. Nikollë Lesi, në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë kohore prej afro një viti, ka ndërmarrë ndaj meje personalisht dhe ndaj bashkëshortit tim, Kryeministrit Fatos Nano, një fushatë shpifjesh e fyerjesh, me synimin e qartë e të paracaktuar për të na denigruar e ulur në sytë e opinionit publik.

Kjo fushatë, prej tij, është përqëndruar në shkrimet e shumta ku ai paraqitet si autor i tyre dhe botues i gazetës së tij "Koha Jonë". Edhe në intervistat e ndryshme të publikuara e të shfaqura në median e shkruar dhe atë televizive shqiptare, e fundit në datën 13/05/2004, në shkelje të rregullave e të etikës së gazetarit ka përsëritur me të njëjtin refren thëniet e tij shpifëse e fyeze.

Në këto shkrime e intervista, ky person me tone nga më fyeset e me shpifje nga më të ultat, hedh baltë ndaj meje e familjes sime sikur unë personalisht qënkam një njeri me një të shkuar të dyshimtë, strumbullar i gjithë kulisave që ndodhin në politikën shqiptare, sikur unë qënkam personi që emëroj e shkarkoj drejtuesit e institucioneve shtetërore, sikur kam ngritur biznese me të ardhura të dyshimta e duke arritur të shpifë ndaj meje sikur qenkar e ngatërruar në lojra spiunazhi në favor të shteteve fqinë, dhe të tjera e të tjera thënie të tilla.

Paralelisht me këto, ky person një pjesë të madhe të shpifjeve e fyerjeve ia adreson edhe bashkëshortit tim Fatos Nano dhe familjes sime, duke na cënuar rëndë në këtë mënyrë në nderin e dinjitetin personal e familjar.